




Kingdom of the Netherlands



Broshurë informative mbi zgjedhjet parlamentare

2025

në Shqipëri



Broshurë informative
mbi zgjedhjet parlamentare
2025
në Shqipëri



Kingdom of the Netherlands



*Ky botim bëhet në kuadër të projektit “**Strong Partnerships for Sustainable Reforms - Strengthening the role of civil society in addressing challenges for free and fair elections**”, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta përmes programit MATRA.*

Përmbajtja e broshurës është përgjegjësi vetëm e ekipit realizues të Institutit të Studimeve Politike dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e ambasadës.

Të drejtat e autorit

© Instituti i Studimeve Politike

Autor
Afrim Krasniqi

ISBN 9789928484635

Shkurtime

BE	Bashkimi European
GNV	Grupet e Numërimit të votave
GJKKO	Gjykata kundër Krimet të Organizuar
KAS	Komisioni Apelimit dhe Sanksioneve
KM	Këshilli i Ministrave
KQV	Komisioni i Qendrave të Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRR	Komisioni Rregullator
KSH	Kuvendi i Shqipërisë
KSHZGJ	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
KV	Komiteti i Veteranëve
KZAZ	Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor
KZGJ	Kodi Zgjedhor
KZGJ	Kolegji Zgjedhor
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
LZHK	Lëvizja për Zhvillim Kombëtar
M	Mazhoritar
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin European
P	Proporcional
PAA	Partia Agrare Ambientaliste
PBDNJ	Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
PBK	Partia Balli Kombëtar
PBKD	Partia Balli Kombëtar Demokrat
PD	Partia Demokratike
PDIU	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
PDK	Partia Demokristiane
PKD	Partia Kristiandemokrate
PL	Partia e Lirisë
PLL	Partia Lëvizja e Legalitetit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PPSH	Partia e Punës së Shqipërisë
PR	Presidenti i Republikës
PRSH	Partia Republikane
PS	Partia Socialiste
PSD	Partia Socialdemokrate
RSH	Republika e Shqipërisë
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Krimet dhe Korrupsionit

Përmbajtje

Hyrje.....	5
MBI ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2025.....	8
HISTORIA E ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE NË SHQIPËRI (1991-2021).....	11
Të dhënat dhe tiparet kryesore të zgjedhjeve 1991-2021.....	12
Zgjedhjet parlamentare 1991.....	12
Zgjedhjet parlamentare 1992.....	13
Zgjedhjet parlamentare 1996.....	14
Zgjedhjet parlamentare 1997.....	15
Zgjedhjet parlamentare 2001.....	16
Zgjedhjet parlamentare 2005.....	17
Zgjedhjet parlamentare 2009.....	18
Zgjedhjet parlamentare 2013.....	20
Zgjedhjet parlamentare 2017.....	21
Zgjedhjet parlamentare 2021.....	22
Pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare (1991 – 2021).....	23
SISTEMI ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2025.....	25
Sistemi zgjedhor 2025.....	26
Për çfarë votohet në zgjedhjet parlamentare?.....	28
Votimi elektronik, Vorë dhe zona 10 Tiranë.....	28
12 parti me mandate të siguruara.....	29
Pragu zgjedhor për zgjedhjet 1991-2025.....	29
Zonat zgjedhore.....	30
Përfaqësimi i detyrueshëm gjinor.....	31
Votimi dhe nxjerrja e rezultateve.....	32
Rregullat e financimit në zgjedhje.....	32
Monitorimi i zgjedhjeve.....	33
ADMINISTRIMI ZGJEDHOR.....	35
KQZ dhe strukturat e administrimit zgjedhor.....	36
Kolegji Zgjedhor.....	37
SUBJEKTET KONKURRUESE NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2025.....	39
Subjektet konkurruese, tiparet dhe pritshmëritë 2025.....	40

Hyrje

Kushtetuta e RSH përcakton parimin “qeverisja bazohet në një sistem zgjedhesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike”, si dhe sovraniteti i përket popullit, populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti. Bazuar në këto parime, Shqipëria i zhvilloi zgjedhjet e para shumëpartiake në mars 1991. Prej atëherë janë mbajtur 10 procese zgjedhore për parlamentin (1991, 1992, 1996, 1997, 2001, 2005, 2009, 2013, 2017 dhe 2021).

Shqipëria ka një traditë të brishtë zgjedhore. Pas periudhës eksperimentale të sistemit pluralist në vitet 1921-1923 vijoi qeverisja republikane dhe monarkiste pa zgjedhje konkurruese dhe pa parti politike. Pas Luftës II Botërore vendosja e sistemit komunist krijoi sistemin e njësimi të partisë me shtetin dhe ndalimin e alternativave të tjera politike. Në dhjetor 1990 u lejua pluralizmi politik dhe në mars 1991 u zhvilluan zgjedhjet e para shumëpartiake. Në mars 1992 u bë rotacioni i parë politik, ndjekur nga një rotacion tjetër më 1997, më 2005 dhe më 2013, vetëm katër raste përgjatë më shumë se tri dekadave.

Shqipëria ka një numër të madh të partive politike (136 në vitin 2025), prej të cilave vetëm një numër shumë i vogël arrijnë të konkurrojnë të kenë përfaqësim parlamentar. Vetëm dy parti, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike kanë pasur përfaqësim të rregullt parlamentar nga viti 1991-1992 dhe në vijim, ndërkohë që partitë e tjera parlamentare kanë pasur sukses për një kohë të shkurtër ose kanë siguruar mbijetesën parlamentare përmes zonave të lira të hyrjes në listat shumëemërore të njërës prej partive të mëdha.

Institucioni i zgjedhjeve është thelbësor për jetësimin e shtetit të së drejtës dhe demokracisë funksionale. Legjitimiteti i zgjedhjeve është i ndërlidhur me legjitimitetin e sistemit politik përfaqësues. Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë pasuar me reforma, qeverisje të qëndrueshme, stabilitet dhe progres drejt integritimit europian. Zgjedhjet e kontestuara ose të bojkotuara janë shoqëruar me rënie të besimit publik tek institucioni i zgjedhjeve dhe demokracia, dobësim të institucioneve përfaqësuese, ngecje të reformave dhe nivel i lartë konfliktualiteti politik apo korrupsioni.

Zgjedhjet e vitit 2025 janë test i rëndësishëm për aftësinë e Shqipërisë për të organizuar dhe zhvilluar zgjedhje me standarde demokratike, proces efektiv dhe qeverisje legjitime dhe me mbështetje publike për reforma. Pavarësisht traditës së brishtë historike dhe bilancit gri gjatë tranzicionit, vlera e zgjedhjeve, si edhe ndikimi i tyre në progresin politik, ekonomik e social mbetet i madh.

Kjo broshurë informative ofron informacionet më të rëndësishme rreth sistemit politik, sistemit zgjedhor, traditës zgjedhore gjatë tranzicionit, aktorëve politik konkurrues dhe administrimit zgjedhor, të gjitha në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të 11 maj 2025. Informimi është thelbësor për të kuptuar trendin e ndjekur me standardet zgjedhore në Shqipëri, sjelljen elektorale dhe specifikat e të gjitha proceseve zgjedhore, përfshirë procesi aktual zgjedhor.

1.

Mbi zgjedhjet
parlamentare

2025



Mbi zgjedhjet parlamentare 2025

Zgjedhjet parlamentare të 11 maj 2025 janë zgjedhjet e 11-ta të zhvilluara në Shqipëri pas ndryshimit të sistemit politik në dhjetor 1990. Zgjedhjet janë të rregullta pas katër vitesh aktivitet të legjislaturës parlamentare të dalë nga zgjedhjet e 25 prillit 2021.

Në datën 5 dhjetor 2024 Presidenti i Republikës Bajram Begaj dekretoi zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare me datë 11 maj 2025. Zgjedhjet e fundit parlamentare ishin mbajtur më 25 prill 2021. Data e propozuar bën pjesë në "periudhën zgjedhore" të sanksionuar nga Kodi Zgjedhor (15 prill – 15 maj si dhe 15 tetor – 15 nëntor). Procesi zgjedhor aktual, sipas traditës, u parapri nga zhvillime politike përgatitore, përfshirë edhe ndërhyrje në Kodin Zgjedhor. Gjatë vitit 2024 Kuvendi bëri ndryshime në legjislacionin zgjedhor në bazë të marrëveshjes politike midis dy partive kryesore Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD). Ndryshimet nuk iu përgjigjen rekomandimeve prioritare të OSBE/ODIHR dhe se u jetësuan pa konsultime publike dhe një proces transparent dhe gjithëpërfshirës. Në shkurt 2025 Kuvendi bëri ndërhyrje të reja plotësuese në legjislacionin zgjedhor, kryesisht për çështjen e shpenzimeve financiare për votën e diasporës.

Zgjedhjet e 11 majit janë unike për Shqipërinë për shkak të tre elementëve. Ato janë zgjedhjet e para që zhvillohen në periudhën kur Shqipëria ka hapur bisedimet e anëtarësimit lidhur me kapitullin I dhe II me Bashkimin Europian (BE). E dyta, gara zhvillohet midis 12 vjet kryeministër Edi Rama dhe 13 vjet kryeministër ose President Sali Berisha, dy prej figurave që kanë dominuar tranzicionin. Mungesa e rotacionit politik të elitave dhe ofertat e njëjta politike prej dy dekadash janë tregues stanjacioni politik. Risia e tretë është aplikimi për herë të parë i votës së diasporës. Sipas të dhënave të KQZ janë regjistruar 245,935 zgjedhës nga diaspora, disa herë më shumë, sesa pritshmëritë fillestare. Mobilizimi erdhi kryesisht nga aktiviteti dhe nxitja e partive politike, jo nga organizimi i vetë diasporës. Duke mos pasur përfaqësim politik votuesit e diasporës do të duhet të zgjedhin midis ofertave të brendshme, de-facto vetë sistemin prej të cilit janë larguar.

Shqipëria qeveriset nga PS prej vitit 2013, fillimisht në koalicion me LSI dhe pas 2017 e vetme, duke pasur pro në çdo rast votat e një aleati jozyrtar si PSD. Modeli i qeverisjes nga një parti e vetme është unik për Shqipërinë dhe u thellua më 2019 kur opozita dorëzoi në mënyrë kolektive mandatet parlamentare, si dhe bojkotoi tërësisht zgjedhjet për qeverisjen

vendore. Në dy zgjedhjet e fundit (parlamentare 2021 dhe lokale 2023) PS fitoi respektivisht 48% dhe 50% të votave, tregues se gjysma e votuesve janë mbështetës të formulës me një parti në qeverisje. Pushteti i gjerë lejon krijimin e një sistemi klientelist punësimi, karriere dhe aksesit në burimet financiare shtetërore, gjë që është konfirmuar edhe nga një sërë raportesh monitoruese, si dhe procesesh hetimore të ndërmarra nga SPAK ndaj zyrtarëve të lartë ekzekutivë dhe politikë. Nga ana tjetër, një opozitë jashtë sistemit dhe prej 2021 edhe në konflikt të brendshëm për kontrollin e PD(2021-2023), dobësoi institucionin e opozitës dhe të demokracisë, si dhe krijoi hendek në raportet dhe mbështetjen publike midis asaj dhe mazhorancës qeverisëse.

Partia Socialiste (PS) nisi përgatitjet për fushatën elektorale në korrik 2024. Në funksion të strategjisë elektorale PS bëri ndryshime në parlament dhe në qeveri. Në përpjekje për të pasur kontroll më politik të Kuvendit ministria Elisa Spiropali zëvendësoi kryetaren e Kuvendit Lindita Nikolla, si dhe u emëruan ministrat e rinj të brendshëm, të mbrojtjes dhe të financave, të gjithë emra të rinj jashtë strukturave të deritanishme të PS. PS caktoi një politikan të lartë si drejtues të diasporës, dhe ndryshoi 80% të drejtuesve në qarqeve, përfshirë Tiranën. Ajo e përshtati strukturën ekzekutive dhe politike me atë elektorale, riformatoi grupet e punës dhe shfrytëzoi kapacitetet shtetërore për të zhvilluar disa ture në diasporë, sidomos në Greqi dhe Itali.

Partia Demokratike (PD) zgjidhi mosmarrëveshjet e brendshme parlamentare duke integruar shumicën e ish - mbështetësve të Bashës, por u vonua në kohë për krijimin e strukturave, si dhe për zhvillimin e zgjedhjeve të brendshme për kandidatët (primare). Në primare nuk pati prurje të reja dhe disa prej fituesve kryesorë, përfshirë në qarkun Tiranë, nuk u përfshinë në listat e kandidatëve për deputetë ose në zonën e listës së mbyllur. PD krijoi një koalicion të gjerë me mbi 20 parti politike, ku bëjnë pjesë PL (ish-LSI), PR, PDK, PBDNJ, PAA, PBK, etj. Ajo nuk arriti të evitojë fragmentarizmin e të djathtës në disa parti të tjera (Mundësia, Djathtas për Zhvillim apo Shqipëria Bëhet). Fuqia e partive aleate, sidomos Partia e Lirisë, u dobësua pas arrestimit me akuzën për korrupsion të kryetarit të saj Ilir Meta dhe mënjanimin nga partia të ish-kryetares së LSI Monika Kryemadhi.

Në aspektin politik Shqipëria shënoi një progres të lehtë, i cili kulmoi me nisjen e bisedimeve për anëtarësim me Bashkimin Europian. Në 15 tetor u hapën negociatat për grup kapitullin e parë me Shqipërinë që përfshin disa fusha thelbësore; drejtësia, gjyqësori, funksionimi i institucioneve demokratike, prokurimi publik, si dhe reforma e administratës publike. Në prill 2025 u hap grupkapitulli i dytë që përfshin tregun e brendshëm.

Zgjedhjet e vitit 2025 zhvillohen në një klimë të re antikorrupsioni, kryesisht për shkak të aktivitetit të SPAK dhe rritjes së ndjeshme të efikasitetit dhe besueshmërisë së tij publike. Kur në shkurt 2025 SPAK dhe GJKKO arrestuan kryetarin e bashkisë Tiranë Erjon Veliaj, figurën e dytë më të rëndësishme politike në qeverisjen e Partisë Socialiste, sondazhet treguan se SPAK është institucioni më i besuar. Gjatë vitit 2024 dhe periudhës parazgjedhore SPAK inicioi hetime serioze edhe ndaj zyrtarëve të tjerë të lartë. Ish-Presidenti Ilir Meta, kryetar i PL, është në gjendje arresti i akuzuar për korrupsion, ish-kryeministri Berisha, kryetar i PD,

është tashmë në proces gjyqësor pas masës 1 vjeçare të sigurisë me arrest në banesë, disa ish-ministra dhe kryetarë bashkie janë të dënuar me burg për korrupsion ose në procese hetimore, shumica absolute e të cilëve i përkatësin Partisë Socialiste. Ish-zv/kryeministri socialist Ahmetaj është gjithashtu në kërkim ndërkombëtar i akuzuar për korrupsion.

Veprimet e SPAK sollën një valë kritikash nga PS dhe përpjekje politike për të rishikuar bazën ligjore të reformës në drejtësi përmes një komisioni të posaçëm parlamentar, si dhe sulme të vazhdueshme publike nga opozita, tek e cila tre kryetarë partish (PD, PL dhe PR) janë në masë sigurie, hetime ose procese gjykimi nga SPAK/GJKKO. Mazhoranca ka iniciuar një komision të posaçëm parlamentar për të adresuar rekomandimet për ndërhyrje, komision i cili është bojkotuar nga opozita dhe konsiderohet gjerësisht si instrument presioni politik sesa reformimi institucional.

Në aspektin social gjatë vitit 2024 Shqipëria vijoi të ecë në dy linja paralele, nga njëra anë një progres i jashtëzakonshëm në fushën e turizmit dhe nga ana tjetër, tendenca të larta të emigrimit nga vendi, kryesisht nga brezi i ri dhe shtresat e mesme, shumë prej tyre ekspertë dhe profesionistë të fushës. Motivi kryesor i emigrimit konsiderohet pasiguria sociale dhe e perspektivës, korrupsioni dhe hendeku i thellë midis një pakice të mbipushtetshme dhe një shumice qytetare të cënuar në të drejtat e tyre, ndërkohë që klasa politike nuk ka arritur të ofrojë nisma, klimë dhe alternativa ndryshimi për frenimin e emigrimit dhe mobilizimin e potencialeve të ekspertizës në të gjithë sektorët e shtetit dhe shoqërisë.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 reflektojnë këtë klimë dhe përballen me sfidën kryesore, rikthimin e fokusit dhe besimit të reformat, mirëqeverisja dhe progresi në drejtim të demokracisë funksionale e shtetit të së drejtës, pra një qasje më "europiane".

2.

Historia e zgjedhjeve
parlamentare
në Shqipëri
(1991 – 2021)

Të dhënat dhe tiparet kryesore të zgjedhjeve (1991 – 2021)


Paraqitja e përmbledhur e të dhënave mbi zgjedhjet parlamentare 1991-2021 është e rëndësishme për të kuptuar kurbën e përfaqësimit politik, sistemet zgjedhore të aplikuara, impaktin që kanë pasur sistemet në të njëjtin mjedis politik dhe me të njëjtët aktorë politikë, si dhe prurjet e reja brenda sistemit politik, rolin e partive tradicionale dhe specifika të tjera të përfaqësimit. Zgjedhjet legjitime dhe të gjithëpranuara forcojnë demokracinë dhe sjellin mjedis mbështetës për reforma, zgjedhjet e kontestuara shoqërohen me krizë të sistemit, bojkot, incidente dhe rënie të besimit publik tek institucionet dhe demokracia.

Zgjedhjet parlamentare 1991¹

Zgjedhjet e vitit 1991 janë të parat zgjedhje shumëpartiake që nga viti 1923. Sistemi zgjedhor ishte 100% mazhoritar në 250 zona zgjedhore, ku kandidatët fitues duhet të kishin 51% të votave në raundin e parë (31 mars), kandidatët midis 25% dhe 50% kalonin në balotazh në raundin e dytë (7 prill) dhe në zonat ku kandidatët kishin maksimumi nën 25% vota kalonin në një raund të tretë (14 prill). Pjesëmarrja në zgjedhje ishte masive 98.92%, ose 1,963,568 votues.

Në zgjedhje u regjistruan 1,074 kandidatë, nga 11 subjekte politike, prej të cilave 5 parti politike (PPSH, PD, PR, PA, PE), një organizatë, (Omonia), si dhe 5 subjekte satelite të PPSH (FD, BP, BR, BG, KV), në total 11 subjekte. Parti opozitare ishin PD dhe PR, Omonia pa pozicion politik dhe të gjitha të tjerat mbështetëse të PPSH. Në raundin e parë fituan 131 kandidatë, në raundin e dytë 17 dhe 2 deputetë në raundin plotësues të tretë. Sipas rezultatit final të zgjedhjeve Partia e Punës (PPSH) fitoi 169 deputetë ose 67,6%, Partia Demokratike (PD) 75 deputetë ose 30 %, "Omonia" 5 deputetë ose 2 %, si dhe Komiteti i Veteranëve 1 deputet ose 0.4 %.

¹Marrë nga libri: "Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008", Konica, Tiranë 2009, autor Afrim Krasniqi.




Legjislatura e parë zgjodhi Presidentin e ri, abrogoi Kushtetutën e vitit 1976 dhe miratoi një paketë të re kushtetuese, Dispozitat Kryesore Kushtetuese.

Zgjedhjet parlamentare 1992²

Zgjedhjet e vitit 1992 kryen rotacionin e parë politik në Shqipërinë pluraliste. Për herë të parë që në historinë e shtetit shqiptar, një qeveri u largua me votim të fshehtë të shumicës së qytetarëve dhe një qeveri e re u zgjodh nga qytetarët për të drejtuar vendin. Zgjedhjet u vendosën të mbahen në datën 1 mars 1992, por për shkak të vonesave në përgatitje, më 11 shkurt 1992 palët ndryshuan mendje dhe vendosën shtyrjen e tyre për në datën 22 mars 1992.

Parlamenti i ri do të përbëhej nga 140 deputetë, 110 më pak, sesa parlamenti i mëparshëm. Nga 140 deputetë gjithsej, 100 do të zgjidheshin mbi bazën e votimit mazhoritar për kandidatët e partive, pjesa tjetër do të ndahej midis partive politike që do të fitonin jo më pak se 4% të votave në shkallë kombëtare. Zgjedhjet u mbajtën në dy raunde, në datat 22 dhe 29 mars dhe KQZ shpalli se në to u regjistruan 2.021.169 zgjedhës, nga të cilët votuan 1.826.142 zgjedhës ose 90,35% e tyre.

²Marrë nga libri: "Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008, Konica, Tiranë 2009, autor Afrim Krasniqi.




Në zgjedhje u regjistruan rreth 500 kandidatë nga 11 parti të ndryshme politike. Në mazhoritar PD fitoi 90 vende, 6 u fituan nga PS, 1 nga PSD, 1 nga PR dhe dy nga PBDNJ. Mandatet shtesë me 40 deputetë u ndanë 32 për PS, 2 për PD dhe 6 për PSD. Përfundimisht, parlamenti përbëhej nga 92 deputetë demokratë, 38 socialistë, 7 socialdemokratë, 1 republikan dhe 2 deputetë të PBDNJ. Vetëm 8 nga 140 deputetë ishin gra, 88 deputetë zgjidheshin për herë të parë në një parlament pluralist. Pjesa tjetër prej 52 deputetësh, 39 nga PD, 12 nga PS dhe 1 nga PBDNJ arritën ta rikonfirmojnë mandatin e tyre.

Zgjedhjet parlamentare 1996³

Zgjedhjet e vitit 1996 përbëjnë një nga momentet kryesore të zhvillimeve politike gjatë periudhës së tranzicionit. Ato u përshkuan nga incidente dhe kontestime të mëdha. Zgjedhjet u bënë me një ligj të ri zgjedhor, sipas të cilit ruhej sistemi miks i votimit, por nga 100 zona në mazhoritar rritej numri në 115 zona, kurse nga 40 mandate në proporcional ulej numri i mandateve në 25 mandate. Sipas të dhënave zyrtare, numri i votave të vlefshme ishte 1,646,481, me pjesëmarrje 89% në raundin e parë dhe me rreth 250,000 vota të pavlefshme ose 13% e votave totale.

Nga të dhënat zyrtare rezulton se PD kishte fituar 55,5% të votave ose 32,5% më shumë, sesa përqindja e vendeve në parlament. Shprehur me vota, PD mori rreth 915 mijë vota, rreth 600 mijë vota më shumë se PS. Shprehur me përqindje, PS mori 20,4% të votave ose 13,4% më shumë, sesa përqindja e vendeve në parlament. Një numër i madh votuesish, rreth 250 mijë, kishin votuar për tri partitë aleate me PD (PR, PBDNJ dhe PBK) dhe bashkë me dy partitë e tjera të djathta, PDK dhe PBD, votat e aleatëve të PD ishin të njëjta me votat e PS, një përfundim i vështirë për t'u pranuar.

³Marrë nga libri: "Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008, Konica, Tiranë 2009, autor Afrim Krasniqi.




Në përfundim të zgjedhjeve procesi u kontestua tërësisht. Partitë kryesore të opozitës bojkotuan edhe raundin e dytë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në 17 zona, ku fitues dolën disa parti të vogla aleate të së djathtës, me mandate të dhuruara në shkëmbim të pjesëmarrjes në zgjedhje.

Zgjedhjet parlamentare 1997⁴

Zgjedhjet parlamentare të vitit 1997 ishin zgjedhjet e dyta të parakohshme parlamentare që nga viti 1990 dhe duhej t'i jepnin fund krizës së rëndë politike dhe sociale për të sjellë stabilitet politik dhe ekonomik. Ato ishin zgjedhje emergjence dhe larg standardeve demokratike, por "të pranueshme për momentin".

Në zgjedhjet e vitit 1997 morën pjesë 19 subjekte elektorale. U ndryshua sistemi zgjedhor, sipas të cilit, numri i deputetëve do të rritej nga 140 në 155, nga të cilët 115 do të zgjidheshin drejtpërdrejt në zona një-emërore, kurse 40 mandatet e tjera shtesë u jepën kandidatëve që janë në listat e subjekteve në shkallë vendi, në bazë të votave të fituara gjatë votimit në raundin e parë". Ndarja e mandateve plotësuese, me një formulë të komplikuar, shkonte në favor të partive që fitonin jo më pak se 2% të votave, fituesit duhej të ishin sipas renditjes në listë, kushti proporcional për kandidim në 38 zona në 12 rrethe thjeshtëzohej me 25 zona në 10 rrethe.

⁴Marrë nga libri: "Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008, Konica, Tiranë 2009, autor Afrim Krasniqi.



Përfituesja kryesore në zgjedhje do të ishte Partia Socialiste, e cila fitoi rreth 360 mijë vota më shumë se më 1996-n ose 27% të votave kombëtare më shumë se PD dhe koalicioni i saj “Bashkimi për Demokracinë”. Partia Demokratike pati një rënie drastike, ajo në çdo tri vota të saj humbi dy dhe në rang kombëtar humbja ishte edhe më e thellë, çdo katër vota ajo humbi tri. Për shkak të ligjit, Partia Socialiste fitoi 22 vende në listën proporcionale dhe në total rreth 101 deputetë, ndaj 24 deputetë të PD. Pjesën tjetër i fituan partitë aleate, kryesisht përmes zonave të lira të dhëna nga PS ose përfshirjes në listën shumë-emërore nga PD. Nga 155 deputetë, 10 ishin gra dhe 103 deputetësh ose 66% e deputetëve u zgjodhën për herë të parë.


Zgjedhjet parlamentare 2001⁵

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2001 u ndikuan nga zgjedhjet e ardhshme presidenciale (2002) dhe synimi i mazhorancës për të kaluar kufirin e 84 votave të nevojshme për Presidentin. Nga e majta, PS doli e vetme në zgjedhje, ashtu si edhe aleatët politikë, PSD, PBDNJ, PA dhe PAD, kurse PD krijoi një aleancë zgjedhore PR, PBK, PLL dhe BLD me emrin “Bashkimi për Fitoren”. Në shkëmbim, PD dhuroi disa mandate parlamentare për aleatët e vet politikë.

Në total konkurruan 1114 kandidatë në 100 zona zgjedhore, 149 ishin kandidatë të pavarur. Nga ky numër, vetëm 78 kandidatë (7%) në zonat një-emërore dhe 120 nga 823 (15%) kandidatët në listat proporcionale ishin gra. KQZ raportoi se numri i zgjedhësve ishte 2,499,238, nga të cilët vota të vlefshme ishin 1,323,900. Sistemi zgjedhor ishte i përzier me 100 deputetë të

⁵ Marrë nga libri: “Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008, Konica, Tiranë 2009, autor Afrim Krasniqi.

zgjedhur në votim mazhoritar dhe 40 me votim proporcional, me dy raunde dhe me prag minimal 2,5% për partitë dhe 4% për koalicionet. Për të kaluar pragun e 2.5% për hyrjen në parlament duheshin 33,098 vota.




Zgjedhjet u zhvilluan në pesë raunde, më 24 qershor, 8 korrik, 22 korrik, 29 korrik dhe 19 gusht 2001. Pati përsëritje votimesh, debate dhe kontestime në shumë zona elektorale. Pas raundeve zgjedhore PS mori 73 vende, kurse koalicioni opozitar 32 vende, Partia Demokratike 6 vende, Partia Socialdemokrate 4 vende, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 3 vende, Partia Agrare 3 vende dhe Partia Aleanca Demokratike 3 vende. Ndikimi i zonës 60 (e njohur si zona e Dushkut - Lushnjë) ndikoi në deformimin e përfaqësimit me +/-10 deputetë, 1 në mazhoritar dhe 9 në proporcional.

Zgjedhjet parlamentare 2005⁶

Zgjedhjet e vitit 2005 ishin të një rëndësie të veçantë, sepse ishin shans për rotacion dhe sprovë për zhvillimin e qëndrueshëm të procesit demokratik në Shqipëri. Në zgjedhje pati 57 parti konkurruese, nga të cilat 10 parti nuk paraqitën asnjë listë shumë-emërore për zgjedhjet në shkallë vendi, 19 parti do të kandidonin si pjesë e katër koalicioneve dhe 28 parti do të konkurronin veçmas në garën për listat kombëtare shumë-emërore. Në total 2,85 milion votues të regjistruar u thirrën për të votuar 1235 kandidatë në votimet direkt në mazhoritar dhe disa qindra kandidatë në listat shumë-emërore.

⁶Marrë nga libri: "Zgjedhjet në Shqipëri 1991-2008, Konica, Tiranë 2009, autor Afrim Krasniqi.




Sistemi i votimit mbeti i njëjtë (100 zona në mazhoritar dhe 40 në proporcional) me dallimin, se zgjedhjet në mazhoritar do mbaheshin për herë të parë me vetëm një raund. Në PS në qeveri u krijuan konflikte politike dhe një fraksion politik krijoi LSI, forca e tretë politike në mazhoritar pas 2005. Në funksion të skemave taktike, partitë krijuan koalicione politike. PS krijoi koalicion me aleatët e vet të vegjël, dhe 7 parti politike aleate me PD krijuan koalicionin -Aleanca për Liri, Drejtësi dhe Mirëqenie“(ALDM).

Në përfundim të zgjedhjeve e djathta fitoi më shumë vende në mazhoritar dhe mori mandatin qeverisës. Në votimin në proporcional kalimi i votave nga PD tek aleatët funksionoi shumë më mirë, sesa tek koalicioni i majtë, për pasojë, e djathta siguroi një numër mandatesh shtesë. Gjithashtu ndihmë për rotacionin ishte edhe ndarja e votave midis PS e LSI në rreth 15-18 zona.

Zgjedhjet parlamentare 2009

Zgjedhjet e vitit 2009 u bënë me sistemin e ri zgjedhor të ndryshuar në prill 2008 me ndryshimet kushtetuese. Në sistemin e ri zgjedhor, për herë të parë u aplikua sistemi proporcional rajonal, me lista të mbyllura dhe me prag zgjedhor 3% për partitë dhe 4% për koalicionet politike.




Në zgjedhjet e vitit 2009 morën pjesë 35 subjekte zgjedhore të ndara në katër koalicione të mëdha politike. E djathta në qeveri krijoi "Aleanca e Ndryshimit" me 16 subjekte politike dhe fitoi 70 mandate me rreth 712 mijë vota proporcionale. Koalicioni kryesor opozitar i drejtuar nga PS quhej "Koalicioni për Ndryshim" me 5 parti politike. Ai fitoi 66 mandate parlamentare dhe 688 mijë vota proporcionale. Koalicioni i tretë drejtohej nga LSI dhe përbëhej nga 6 parti. Ai fitoi 4 mandate parlamentare dhe rreth 84 mijë vota proporcionale. Koalicioni i katërt, Aleanca Poli i Lirisë, me parti të vogla të së djathtës, nuk mori asnjë mandat megjithëse siguroi rreth 27 mijë vota në proporcional. Këto janë zgjedhjet e vetme ku partia fituese në proporcional humbi zgjedhjet duke marrë më pak mandate, sesa partia e dytë në proporcional.

Pas zgjedhjeve PD krijoi koalicion me LSI e drejtuar nga ish - kryeministri socialist Ilir Meta, si dhe më 2012 zgjodhi President kryetarin e grupit të saj parlamentar. Gjatë këtij mandati u shënua progres në aspektin e reformave dhe integritit, por një numër skandalesh çuan në konsumimin e pushtetit dhe në ngjarjen e rëndë të vitit 2011, kur gjatë një proteste të dhunshme mbetën të vrarë 4 qytetarë mbështetës të opozitës. Disa muaj më pas koalicioni PD-LSI arriti të fitojë garën individuale të liderit të opozitës për kryetar bashkie në Tiranë.

Zgjedhjet parlamentare 2013

Zgjedhjet e vitit 2013 u zhvilluan në një kontekst të ri politik: e majta hyri e bashkuar në zgjedhje, për herë të parë që prej 2001. Zgjedhjet sollën rotacion politik. Ato u zhvilluan me sistemin proporcional rajonal, dhe pa ndryshime të rëndësishme teknike dhe administrative nga zgjedhjet e vitit 2009.




Në zgjedhjet 2013 morën pjesë 66 parti politike dhe dy kandidatë të pavarur. Partitë e djathta (24 parti) krijuan Aleancën për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim, kurse partitë e majta (39 parti) krijuan Aleancën për Shqipërinë Evropiane. Koalicioni i majtë fitoi 993 mijë vota dhe 83 deputetë, kurse koalicioni i djathtë fitoi 680 mijë vota dhe 57 deputetë. Dy partitë e reja politike, FRD dhe AKZ fituan rreth 40 mijë vota, por nuk siguruan asnjë mandat parlamentar.

Rotacioni politik ishte i pritshëm kur në datën 1 prill 2013 LSI në qeveri vendosi largimin dhe krijimin e një koalicioni të gjerë me PS në opozitë. E majta mori numër rekord votash dhe vendesh në parlament, si dhe kryetari i LSI u bë fillimisht kryetar parlamenti dhe në përfundim të legjislaturës President i Republikës.

Gjatë këtij mandati u shënuan arritje të rëndësishme në kursin e reformave në disa sektorë, përfshirë reforma territoriale, ajo në arsimin e lartë dhe e shërbimeve online, si dhe në kontrollin e territorit. Reforma më e rëndësishme ishte ajo në drejtësi e votuar unanimisht nga 140 deputetët.

Zgjedhjet parlamentare 2017

Zgjedhjet e qershorit 2017 u shtynë një javë pas mosmarrëveshjeve politike midis qeverisë dhe opozitës. Një krizë politike çoi në marrëveshjen e datës 18 maj për të aplikuar eksperimentin me gjashtë ministra teknikë në qeveri, të propozuar nga opozita, si dhe emërimet e tjera në administratën e lartë, si masa sigurie për mospërdorimin e burimeve shtetërore në zgjedhje. Marrëveshja solli konsensus për zgjedhjen e organeve të vetingut në drejtësi dhe Avokatin e Popullit, miratimin e ministrave teknikë si pjesë e qeverisë dhe përgatitjet zgjedhore.




Në zgjedhje morën pjesë 18 parti politike dhe 2,666 kandidatë, përfshirë 1,073 gra (40 për qind). Në këtë proces për herë të parë u përdorën standardet e ligjit të dekriminalizimit, disa deputetë humbën mandatin për shkak të rekordeve penale. Sistemi i votimit mbeti proporcional me lista të mbyllura, me prag zgjedhor 3% për partitë dhe 5% për koalicionet. Në zgjedhje morën pjesë 1,58 milionë zgjedhës ose 46% e totalit. Partia Socialiste fitoi 74 mandate me rreth 765 mijë vota, ndjekur nga PD me 43 mandate me rreth 456 mijë vota dhe LSI u rrit ndjeshëm me 19 mandate dhe 225 mijë vota. Nga partitë e tjera politike vetëm PDIU dhe PSD siguruan mandate, përkatësisht 3 dhe 1 mandat. PS u bë partia e parë gjatë tranzicionit që krijoi qeveri e vetme, pa pasur nevojë për aleanca politike, LSI kaloi në opozitë ndonëse kishte Presidentin e Republikës.

Legjislatura e vitit 2017 mori goditje të madhe në shkurt 2019 kur konfliktet dhe mosmarrëveshjet politike çuan në vendimin e opozitës për dorëzim kolektiv të mandateve parlamentare. Një pjesë e mandateve u morën nga kandidatë të listave shumëëmërore të partive të vogla aleate, por përgjatë dy viteve parlamenti pati vetëm 122 deputetë në total nga 140 që duhej të kishte.

Zgjedhjet parlamentare 2021

Zgjedhjet e 25 prillit 2021 u zhvilluan gjatë pandemisë globale të COVID-19, si dhe ato u paraprinë nga kontrolli i plotë i njësisë të qeverisjes vendore nga PS pasi zgjedhjet lokale të vitit 2019 u bojkotuan nga partitë e opozitës. Zgjedhjet u shoqëruan edhe me disa ndryshime të rëndësishme në sistemin zgjedhor, të cilat parandaluan votën për partitë në koalicione dhe aplikuan votimin preferencial, sipas të cilit kandidatët me mbi 10 mijë vota mund të fitonin mandat duke zhvendosur emrat në krye të listës proporcionale të partive politike. Si rezultat, nga 19 kandidatë që tejkaluan herësin përkatës, por vetëm 4 kandidatë morën mandat për shkak të ndryshimit të pozicionit të tyre fillestar në listë.




Pragu zgjedhor u ul në 1%, në një zonë në Tiranë u aplikua projekti pilot i votimit dhe numërimit elektronik, si dhe kryetarët e partive kishin të drejtë kandidimi në katër qarqe. Në total kandiduan 1871 kandidatë nga 10 parti politike dhe 2 koalicione, si dhe 5 prej tyre ishin kandidatë të pavarur. Në zgjedhje votuan 1.6 milionë qytetarë, nga të cilët 768 mijë votuan për PS, 622 mijë për PD dhe 107 mijë për LSI. Jashtë tyre fitoi mandate edhe PSD me 35 mijë vota. PS mori të njëjtin numër mandatesh si në zgjedhjet e vitit 2017, 74 mandate, si dhe gjatë legjislaturës siguroi edhe votat e 4 deputetëve të tjerë, përfshirë 1 nga LSI dhe 3 nga PSD.

Legjislatura parlamentare u shoqërua me skandale dhe problematika të shumta, përfshirë krizën përçarëse në PD gjatë viteve 2021-2023. Mazhoranca u confirmua edhe në zgjedhjet e pjesshme lokale të vitit 2022 dhe ato të rregullta 2023, duke ruajtur shumicën absolute në dy nivelet e qeverisjes, qendrore dhe lokale.

Pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare (1991 – 2021)



Pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare



Pjesëmarrja në zgjedhje ka ndryshuar nga 1991 dhe 1992 duke rënë rreth 50%-55%. Kurba e rënies lidhet me rritjen e numrit të qytetarëve mosbesues tek partitë politike, por edhe me problematika të identifikimit të shtetasve për shkak të emigrimit masiv në vite. Në zgjedhjet e viteve 1991-1992, kur shteti kishte të dhëna të sakta të numrit të qytetarëve me të drejtë vote, janë regjistruar edhe shifrat më të vogla të numrit të zgjedhësve në listë dhe përqindjet më të larta të pjesëmarrjes në votime.

Gjatë viteve raportet janë përmbysur. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2017 pjesëmarrja në zgjedhje ishte 46,76%, kurse në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2021 pjesëmarrja ra me 1%. Kjo lidhet dhe me rënien e numrit të popullsisë aktive. Sipas INSTAT numri i popullsisë banuese më 2023 ishte 2,402,113, dukshëm më e vogël, sesa numri 2.876.591 konfirmuar nga INSTAT më 2017.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 pritet të ketë pjesëmarrje më të lartë për shkak të mbi 200 mijë shtetasve të regjistruar nga diaspora, shumica absolute e të cilëve nuk kanë votuar në zgjedhjet e mëparshme.

3.

Sistemi zgjedhor
për zgjedhjet
parlamentare
2025

Sistemi zgjedhor 2025

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 zhvillohen mbi bazën e përcaktuar nga ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 (sistemi proporcional) dhe 2020 (ndalimi i koalicioneve të hapura). Sistemi proporcional ishte dakordësi e dy partive të mëdha politike, kurse ndryshimet e vitit 2020 ishin vendimmarrje vetëm e Partisë Socialiste. Shqipëria është e ndarë në 12 zona elektorale (12 qarqe) me numër të ndryshëm deputetësh. Subjektet politike konkurrojnë me dy lista, një listë të mbyllur (një e treta e vendeve) dhe një listë të hapur (dy të tretat e vendeve). Për shkak të sistemit zgjedhor dhe rolit dominues të dy partive të mëdha listat e mbyllura përcaktojnë rreth 90-94 deputetë të ardhshëm nga 140 deputetë në total.

Tabela paraqet ndryshimet më të rëndësishme në sistemin zgjedhor në tri zgjedhjet e fundit parlamentare. Në vitin 2017 votohej me lista të mbyllura (vetëm partia/subjekti politik), në zgjedhjet pasuese të vitit 2021 u aplikua votimi konkurrues përmes herësit me mbi 10 mijë vota dhe në zgjedhjet e vitit 2025 aplikohet ndarja e vendeve në lista të mbyllura dhe të hapura. Ndryshimet e vazhdueshme të sistemit zgjedhor dhe formulës rreth mandateve lidhen me interesat afatshkurta të partive të mëdha politike dhe pjesërisht edhe me detyrime që burojnë nga vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese.

Ndryshimet periodike në sistemin zgjedhor penalizuan kapacitetet dhe mundësitë për aktorë të rinj politikë dhe parandaluan ndryshime të rëndësishme në sistemin partiak. Vetëm 3 parti politike (PS, PD, LSI) kishin kapacitete në vitin 2021 të zhvillonin fushatë të plotë në nivel kombëtar, në vitin 2025 krahas PS dhe PD pjesërisht vendin e LSI (tashmë PL) si aktor i tretë politik viziv dhe konkurruese në nivel kombëtar e kanë zënë disa parti të reja politike dhe PSD. Aktualisht PL është pjesë e koalicionit me PD.

3 ZGJEDHJE PARLAMENTARE – 3 EKSPERIMENTE ZGJEDHORE		
2017	2021	2025
LISTË E MBYLLUR PROPORCIONALE (VOTOHET VETËM PARTIA, JO KANDIDATI). MUND TË VOTOHET ÇDO PARTI NË KOALICION.	LISTË E MBYLLUR ME HERËS 10 MIJË VOTA (VOTOHET PARTIA DHE KANDIDATI). VOTOHET PËR KOALICIONIN JO PARTITË BRENDA TIJ	LISTË E MBYLLUR NË 33%, GARË E HAPUR 67% (VOTOHET PARTIA DHE KANDIDATI, VETËM PARTIA OSE VETËM KANDIDATI)

Nga 1991 janë zhvilluar 9 procese zgjedhore parlamentare: 2 zgjedhje të parakohshme (1992 dhe 1997) dhe 7 procese normale zgjedhore (1991, 1996, 2001, 2005, 2009, 2013 dhe 2017). Vetëm zgjedhjet e vitit 1991 kanë qenë në mazhoritar. Zgjedhjet 1992-2005 janë zhvilluar me një sistem miks, 100 (115) zona në mazhoritar dhe 40 (25) mandate në proporcional. Qëllimi kryesor i këtij sistemi ishte proporcionaliteti midis mbështetjes së partive dhe numrit të mandateve të tyre parlamentare, duke kompensuar partinë e dytë në mazhoritar me mandate në proporcional.

Neni 163 i Kodit Zgjedhor:

Kandidatët e listës shumëmemërore që i nënshtrohen votimit parapëlqyes rirenditen në bazë të numrit më të lartë të votave parapëlqyese për secilin kandidat.

VITI ZGJEDHOR	NUMRI I DEPUTETËVE	SISTEMI ZGJEDHOR	NDARJA MANDATE	FORMA E ZGJEDHJEVE
1991	250	Mazhoritar	250 Mazh	Të jashtëzakonshme
1992	140	Miks (Prop-Mazh)*	100M x 40P	Të parakohshme
1996	140	Miks (Prop-Mazh)	115M x 25P	Të zakonshme
1997	155	Miks (Prop-Mazh)	115M x 40P	Të parakohshme
2001	140	Miks (Prop-Mazh)	100M x 40P	Të zakonshme
2005	140	Miks (Prop-Mazh)	100M x 40P	Të zakonshme
2009	140	Proporcional Rajonal	140 Proporcional	Të zakonshme
2013	140	Proporcional Rajonal	140 Proporcional	Të zakonshme
2017	140	Proporcional Rajonal	140 Proporcional	Të zakonshme
2021	140	Proporcional Rajonal	140 Proporcional	Të zakonshme
2025	140	Proporcional Rajonal	140 Proporcional	Të zakonshme

*Miks (Pr-Mazh) do të thotë: sistem “Miks – Proporcional + Mazhoritar”

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 u vendos kalimi në sistemin proporcional rajonal, me lista të mbyllura dhe me prag minimal zgjedhor 3%. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2020 u vendos ulja e pragut elektoral në 1% dhe aplikimi për herë të parë i listave të hapura proporcionale.

Numri i deputetëve ka ndryshuar vetëm në dy raste: në vitin 1991 u ruajt numri i deputetëve i legjislativave të fundit të periudhës komuniste (250 deputetë), si dhe në vitin 1997 u ruajt sistemi i vitit 1996 me rritjen e numrit të deputetëve në proporcional nga 25 në 40 vende, për pasojë, parlamenti kishte 155 deputetë.

Për çfarë votohet në zgjedhjet parlamentare?

Në përvojën zgjedhore 1991-2021, me ndryshimet në sistemin e votimit ka ndryshuar edhe mënyra e votimit të qytetarëve. Në vitin 1991 zgjedhësi nuk votonte partinë në fletën e votimit, por emrin e kandidatit të propozuar nga partitë/subjektet politike. Midis 1992-2005 është votuar për partinë dhe për kandidatin, pra me dy fletë votimi. Pas vitit 2008 deri në vitin 2019 është votuar vetëm për partinë politike me një fletë votimi. Në vitin 2021 do të votohet për partinë dhe kandidatin e preferuar në listën e saj.

Zgjedhjet e viteve 1992-2001 kanë qenë me dy raunde në votimin mazhoritar. Në vitin 2005 u aplikua sistemi me një raund në mazhoritar. Pas vitit 2008 nuk ka raund votimi, për shkak se nuk ka votim rivalizues midis kandidatëve, për rrjedhojë është votuar vetëm për partinë politike. Në vitin 2025 do të votohet përsëri në një ditë votimi.

VITI	ZGJEDHËSI VOTON	NUMRI I RAUNDEVE
1991	Voton kandidatin	Dy raunde
1992	Voton kandidatin dhe partinë	Votë mazhoritare në dy raunde
1996	Voton kandidatin dhe partinë	Votë mazhoritare në dy raunde
1997	Voton kandidatin dhe partinë	Votë mazhoritare në dy raunde
2001	Voton kandidatin dhe partinë	Votë mazhoritare në dy raunde
2005	Voton kandidatin dhe partinë	Votë mazhoritare në një raund
2009	Voton partinë / koalicionin	Votë proporcionale, 1 raund
2013	Voton partinë / koalicionin	Votë proporcionale, 1 raund
2017	Voton partinë / koalicionin	Votë proporcionale, 1 raund
2021	Voton partinë dhe kandidatin	Votë proporcionale, 1 raund
2025	Voton partinë dhe/ose kandidatin	Votë proporcionale, 1 raund

Votimi elektronik, Vorë dhe zona 10 Tiranë

Shqipëria ka zhvilluar debat të gjatë lidhur me përdorimin e teknologjisë në zgjedhje. Më 2017 u tentua aplikimi pa sukses i teknologjisë, më 2021 u aplikua në zonë pilot, më 2023 gjithashtu në disa njësi vendore.


Në zgjedhjet e vitit 2025 është vendosur të aplikohet vetëm në dy zona, në bashkinë Vlorë dhe në njësinë 10 në Tiranë. Njësia 10 votoi në formë elektronike në vitin 2021, ndërsa Vora në vitin 2023. Në Vorë janë rreth 30 mijë zgjedhës, ndërsa në njësinë 10, rreth 40 mijë. Sistemi elektronik nuk të lejon të zgjedhësh më shumë se një kandidat nga lista, duke shmangur kështu shanset për votë të pavlefshme.

12 parti me mandate të siguruara

Në zgjedhje konkurrojnë 11 subjekte politike, por ndërkohë përmes listës së mbyllur të kandidatëve disa parti politike kanë siguruar përfaqësim parlamentar pa qenë subjekte direkte në fushatë. Konkretisht, referuar listës shumëemërore të PD i janë dhënë mandate të sigurt 10 partive politike të mëposhtme, Partia e Lirisë (PL), Partia Republikane (PR), Bashkimi i të drejtave të njeriut (PDBNJ), Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), Partia Agrare Ambientaliste (PAA), Partia Demokristiane (PDK), Partia Fryma e Re Demokratike (FRD), Partia Balli Kombëtar (PBK), Lëvizja e Legalitetit (PLL) dhe Balli Kombëtar Demokrat (PBKD). Krahas tyre kanë siguruar mandate edhe PS e PD.

Pragu zgjedhor 1991-2025

Kodi Zgjedhor përcakton detyrimin për kalimin e pragut 1% si kusht për subjektet zgjedhore për t'u përfshirë në ndarjen e mandateve parlamentare. Në zgjedhjet e fundit parlamentare vlera 1% korrespondonte me rreth 16 mijë vota të vlefshme, në zgjedhjet e vitit 2025, me zgjerimin e të drejtës së votës për diasporën, pragu mund të rritet. Nga sondazhet e deritanishme rezultojnë se gjashtë subjekte, - PS, PD, Bashkë, Shqipëria Tjetër, Mundësia dhe PSD, mund të kalojnë pragun zgjedhor duke pretenduar mandate parlamentare. Për partitë e tjera më të vogla ekzistojnë mundësi ende të pa verifikuara përmes sondazheve.



Krahas pragut zgjedhor në nivel kombëtar sistemi zgjedhor parashikon de facto edhe një prag natyral zgjedhor sipas qarqeve. Tabela paraqet numrin e votave shteruese në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, të mjaftueshme për të siguruar mandat parlamentar.

Neni 62 i Kodit Zgjedhor:

Për zgjedhjet për Kuvendin përjashtohen nga shpërndarja e mandateve partitë politike ose koalicionet që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi.


Pragu zgjedhor për mandat në zgjedhjet 2021

	BE	DI	DR	EL	FR	GJ	KO	KU	LE	SHK	TR	VL
PSD	-	-	-	-	-	-	-	-	-	8,213	13,273	-
LSI	-	-	-	-	12,312	-	-	-	-	10,100	13,973	-
PD+	11,519	9,673	10,572	9,646	10,780	14,004	10,096	12,036	8,499	9,441	12,156	8,032
PS	8,471	14,371	9,616	10,778	10,175	8,201	10,091	13,856	9,090	10,099	12,602	7,378

Zonat zgjedhore

KQZ ka përcaktuar zonat zgjedhore mbi bazën e numrit të popullsisë. Caktimi është kryesisht teknik dhe nuk ka kontestime politike. Në nenin 75 të Kodit Zgjedhor parashikohen kriteret dhe procedura për caktimin e numrit të mandateve. Çdo mandat përfaqëson një numër afërsisht të njëjtë shtetasish. Numri total i shtetasve, sipas Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, pjesëtohet me numrin 140 të mandateve të Kuvendit, duke përcaktuar numrin mesatar të shtetasve që i takojnë çdo mandati të Kuvendit. Numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore përcaktohet duke pjesëtuar numrin e shtetasve me vendbanim në zonën zgjedhore, me numrin mesatar.

Në zgjedhjet e vitit 2025 Tirana u shtua me 1 mandat, të cilin e humbi qarku Korçë. Pas Tiranës qarku Fier ka numrin më të madh të deputetëve, 16. Në qarkun Tiranë bëjnë pjesë bashkia Tiranë, bashkia Kamëz, bashkia Vorë, Bashkia Kavajë, Bashkia Rrogozhinë.



Përfaqësimi i detyrueshëm gjinor

Neni 63 i Kodit Zgjedhor parashikon detyrimin që “në çdo tre kandidatë, një i përket gjinisë tjetër”, duke e vendosur këtë detyrim si kusht për regjistrimin e subjekteve elektorale. Neni 163 saktëson se: “kur nga rirenditja nuk rezulton që duke filluar nga kreu i kësaj liste, një në çdo tre emra i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, atëherë kandidati i tretë në këtë listë dhe në vijim një në çdo tre emra të saj i përket gjinisë më pak të përfaqësuar sipas numrit të votave që këto të fundit kanë marrë. Mbi bazën e këtij kriteri hartohet lista përfundimtare që i nënshtrohet votimit parapëlqyes”.

Përfaqësimi gjinor mbrohet edhe në fazën e zëvendësimeve gjatë legjislaturës. Neni 64 përcakton se mandati i ndërprerë i deputetit “i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, përveçse kur plotësimi i vakancës me kandidatin e radhës ul përfaqësimin e gjinisë së nënpërfaqësuar.

Në këtë rast plotësimi i vakancës bëhet nga kandidati i parë në listë i gjinisë së nënpërfaqësuar pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk zbatohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar“.

Votimi dhe nxjerrja e rezultateve

Votimi në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 bëhet në një ditë në të gjithë territorin e vendit. Shqipëria nuk aplikon votim paraprak në ditë të tjera apo forma të tjera të votuesve në pamundësi shëndetësore apo fizike, siç ndodh me disa vende të rajonit. Paralelisht gjatë periudhës zgjedhore ftohen të votojnë edhe qytetarët e regjistruar për votim në portalin online të KQZ nga diaspora. Votat e tyre administrohen në KQZ dhe numërimi nis paralelisht me numërimin e votës brenda.

Votimi mund të bëhet vetëm për kandidatin, për vetëm subjektin politik, për kandidatin dhe subjektin e njëjtë politik, duke vendosur shenjën “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë.

Kodi Zgjedhor parashikon 48 orë afat për numërimin e votave dhe shpalljen e rezultateve paraprake, afat që nuk është respektuar në asnjë nga zgjedhjet e fundit. Neni 162 ngarkon KQZ që jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procesit të ankimit kundër vendimit për miratimin e rezultateve të zonës zgjedhore apo pavlefshmërisë së zgjedhjeve, të përlogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore.

Rregullat e financimit në zgjedhje

Burimet e financimit të fushatës për subjektet zgjedhore janë:

- a) fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit;
- b) të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit;
- c) dhuratat për subjektin zgjedhor dhe kandidatët e tij, në vlerë monetare, natyrë ose shërbime;
- ç) huatë ose kreditë e marra nga partitë politike ose kandidatët e tyre.

Subjektet politike dhe kandidatët mund të marrin fonde për qëllime të fushatës së tyre zgjedhore vetëm nga persona fizikë ose juridikë vendas, duke konsideruar të tillë edhe shtetasit shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

- Shuma që çdo person fizik ose juridik mund t'i japë një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, nuk mund të jetë më e madhe se 1 milion lekë ose kundërvlera në sende ose shërbime.
- Kandidatët e partisë politike ose koalicionit zgjedhor të regjistruar si subjekt zgjedhor

- kanë të drejtë të vetëfinancojnë fushatën e tyre deri në shumën 3 milionë lekë
- Shuma e shpenzimeve të bëra nga një subjekt zgjedhor, pa përfshirë kandidatët e tij, për fushatën zgjedhore, nuk duhet të jetë më shumë se 5 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike.
- Subjektet zgjedhore janë të detyruara të paraqesin raport financiar për fushatën zgjedhore në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve
- Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm shumën e fondeve të përfituara për çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit.

Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 1% të votave në shkallë vendi në zgjedhjet më të afërta pararendëse të të njëjtit lloj, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje.

Monitorimi i zgjedhjeve

Procesi monitorues i zgjedhjeve përfshin aktorë të shumtë vendorë dhe ndërkombëtar. Misioni më i rëndësishëm është misioni i OSBE/ODIHR i drejtuar nga ambasadori Lamberto Zannier. Misioni harton dhe publikon raporte paraprake, si dhe raportin final të zgjedhjeve, i cili del disa muaj pas mbylljes së procesit zgjedhor dhe për rëndësinë e tij bëhet pikë referimi për vlerësimet e standardeve zgjedhore për Shqipërinë. Raportet ofrojnë rekomandime prioritare dhe të përgjithshme për përmirësim në legjislacionin zgjedhor dhe organizimin e tyre.

Krahas misionit të ODIHR disa misione të tjera ndërkombëtare përfshihen në monitorimin e procesit zgjedhor, përfshirë misioni i Këshillit të Europës, nga institucione të BE, si dhe misionet ndërkombëtare perëndimore në Tiranë. Gjetjet e tyre janë të rëndësishme, por nuk ndikojnë në raportin final vlerësues të OSBE/ODIHR.

Një numër të madh vëzhguesish vendore ofrojnë organizatat vendore të shoqërisë civile, të cilat monitorojnë KQZ, vendimmarrjet, aktivitetet përgatitore, periudhën e ndalimit 4 mujor për aktivitetet e ndërlidhura me burimet shtetërore, periudhën elektorale, ditën e votimit dhe periudhën pas elektorale. Grupet e shoqërisë civile mbështeten në angazhimin e tyre nga partnerë të ndryshëm perëndimorë, kryesisht shtete perëndimore dhe organizata perëndimore. Disa prej organizatave publikojnë raporte të thelluara monitorimi në fushat që kanë në fokus gjatë procesit zgjedhor, të tjera i bëjnë publike gjetjet e tyre vetëm në media ose tryeza pune, ndërkohë që gjetjet dhe rekomandimet i adresohen gjithnjë Kuvendit të RSH në kuadër të angazhimit të tij për reforma të ardhshme zgjedhore.

4.

Administrimi
Zgjedhor

KQZ dhe strukturat e administrimit zgjedhor

Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri administrohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Struktura e KQZ (përbërja, mandati dhe zgjedhja) kanë ndryshuar shumë herë gjatë tranzicionit. Midis viteve 1991-1998, KQZ emërohej nga Presidenti dhe Këshilli i Ministrave dhe ishte organ i përkohshëm vetëm për periudhën zgjedhore. Kushtetuta e RSH (1998) e shndërroi KQ-në në organ kushtetues dhe përcaktoi zgjedhjen e tij nga organe kushtetuese. Një ndërhyrje tjetër në Kushtetutë (2007) solli ndryshime në përbërje, por në vitin 2008 ndryshimet kushtetuese e zhvendosën KQZ nga organ kushtetues në organ administrativ që funksionon mbi bazën e Kodit Zgjedhor.

Reforma zgjedhore 2020 aplikoi për herë të parë krijimin e **Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve** si organ monokratik, si dhe ndryshimin thelbësor të strukturës së KQZ. Pas ndryshimeve të vitit 2020 KQZ do të përbëhet nga tri organe:

1. **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** (me mandat 7 vjeçar, zgjedhur nga Kuvendi)
 2. **Komisioni Rregullator** (5 anëtarë me mandat 5 vjeçar, zgjedhur nga Kuvendi)
 3. **Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve** (5 anëtarë me mandat 9 vjeçar, zgjedhur nga Kuvendi)
- Posti i **Nënkomisionerit** (me mandat 4 vjeçar, zgjedhur nga Kuvendi).

Administrimi në nivel zonal bëhet nga **Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ)**, i cili ka në përbërje përfaqësues nga partitë politike në raport të balancuar mazhorancë - opozitë. Me gjithë kritikën dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR kjo përbërje nuk ka ndryshuar as për zgjedhjet e vitit 2025. KZAZ do të kenë 7 anëtarë (2 nga PS, 2 nga PD, 1 nga partia e dytë në qeveri dhe 1 nga partia e dytë në opozitë, 1 në raportet 50% nga Partia Socialiste dhe Partia Demokratike). KZAZ emërohen nga KQZ dhe 30% e anëtarëve duhet të jenë nga secila gjini.

Zgjedhjet në qendrat e votimit administrohen nga Komisioni i Qendrave të Votimit (KQV). KQV vijojnë të jenë me përfaqësues politikë, sipas formulës së KZAZ.

Grupet e numërimit të votave (GNV) administrojnë numërimin e votave. GNV-të përbëhen nga 4 anëtarë, 2 nga mazhoranca dhe 2 nga opozita.

Kolegji Zgjedhor

Trupa e posaçme e krijuar për të trajtuar çështjet zgjedhore është Kolegji Zgjedhor. Zgjedhja e gjyqtarëve bëhet me short midis trupës së apelit dhe mandati është 4 vjet. Për të siguruar mbrojtje nga sulmet e mundshme politike, neni 147 i Kodit Zgjedhor përcakton se *“gjatë mandatit gjyqtari i Kolegjit nuk mund t’i nënshtrohet hetimit apo procedimit disiplinor, nuk mund të lëvizet nga detyra në mënyrë të përkohshme apo të përhershme për shkaqe disiplinore, organizimi gjyqësor, si dhe nuk mund të vlerësohet “i pamjaftueshëm” për aftësitë profesionale dhe etikën/angazhimin ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit”*.

Angazhimi në zgjedhje konsiderohet kontribut shtesë në karrierë, ndaj sipas Kodit, pas përfundimit të delegimit në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, ushtrimi i detyrës në këtë Kolegj konsiderohet vlerë e shtuar në përvojë për qëllime të ngritjes në detyrë.

KQZ

Këshilli
Rregullator

Komisioneri
Shtetëror
i Zgjedhjeve

Komisioneri
i Ankimimeve
dhe
Sanksioneve

Komisionet
zonale
(KZAZ)

Komisionet
zonale
(KZAZ)

Komisionet
e Qendrave të
Votimit

Komisionet
e Numërimit
të Votave

Zgjedhësit

5.

Subjektet konkurruese
në zgjedhjet
parlamentare
2025

Subjektet konkurruese, tiparet dhe pritshmëritë 2025

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 do të marrin pjesë 11 subjekte zgjedhore. Në këto zgjedhje nuk kemi asnjë kandidat të pavarur. Bazuar në Kodin Zgjedhor, çdo subjekt politik duhej të paraqiste në zgjedhje një listë me 186 kandidatë, nga të cilët 46 në listë të mbyllur dhe 140 në listë të hapur. Të dhënat e përgjithshme mbi subjektet zgjedhore ofrojnë më shumë informacion për subjektin, historinë, rolin aktual, lidhshipin dhe pritshmëritë.

1. PARTIA SOCIALISTE (PS)

Link: <https://ps.al>

Kryetar: Edi Rama



Partia Socialiste u krijua më 1991 në kuadër të reformimit të PPSH, si dhe ka qeverisur vendin në periudhat 1991, 1997-2005 dhe 2013-2025. PS është parti e spektrit të majtë politik. Numerikisht ajo është parti më e madhe në vend dhe njëherësh edhe forca politike. PS ka struktura dhe shtrirje në të gjithë vendin dhe në diasporë, si dhe kontrollon në shumicë parlamentin dhe qeveris e vetme pa pasur nevojë për koalicion prej vitit 2027. Në zgjedhjet e vitit 2017 dhe 2021 PS siguroi numër të njëjtë mandatesh (74), objektiv që është edhe në zgjedhjet e vitit 2025. Kryetar i PS është Edi Rama, i zgjedhur në shtator 2009, kryeministër në detyrë prej 2013. Aktualisht PS synon të fitojë mandatin e katërt qeverisës.

2. PARTIA DEMOKRATIKE (PD)

Link: <https://pd.al>

Kryetar: Sali Berisha



Partia Demokratike (PD) është krijuar në vitin 1990, si parti e parë e pluralizmit politik. Ajo ka qeverisur vendin në dy periudha të tranzicionit (1992-1997 dhe 2005-2013). PD është pjesë e spektrit të qendrës së djathtë, promovuese e ekonomisë së tregut, lirive individuale, etj. PD është në opozitë prej vitit 2013 kur humbi zgjedhjet parlamentare dhe vitit 2015 edhe në qeverisjen vendore. Ajo bojkotoi zgjedhjet lokale 2019, si dhe gjatë periudhës 2021-2023 hyri në krizë të brendshme mbi legjitimitetin midis kryetarit aktual Berisha dhe ish-kryetarit Basha. Çështja u zgjidh në rrugë gjyqësore. Në zgjedhjet e vitit 2021 PD fitoi 59 mandate,

disa prej të cilave iu dhuruan aleatëve politikë. Kryetar i PD është Sali Berisha, ish - President 5 vjet dhe ish - kryeministër për 8 vjet. Aktualisht PD synon të fitojë zgjedhjet parlamentare.

3. PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)

Link: <https://psd.al/>

Kryetar: Tom Doshi



Partia Socialdemokrate (PSD) lindi si fraksion liberal nga PPSH më 1991, fitoi 7 mandate më 1992 në koalicion me PD. Pas 1994 ka qenë gjithnjë pjesë e koalicionit të majtë. E drejtuar nga themelimi nga Skënder Gjinushi, më 2019 PSD i kaloi deputetit të PS Tom Doshi, i cili vijon ta drejtojë. Ai fitoi mandate në dy zgjedhjet e fundit parlamentare, më 2021 fitoi 3 mandate, por dha dorëheqje nga mandati pas sanksioneve të shpallura nga qeveria amerikane. Në zgjedhjet e fundit lokale 2023 PSD fitoi 116 vende në këshillat bashkiakë, të shpërndara në 44 bashki të vendit. PSD nuk shfaqet më si parti ideologjike, natyra e saj klienteliste është baza e mbështetjes sidomos në zonat periferike të qarkut Shkodër. Aktualisht PSD synon të ruajë mandatet parlamentare.

4. KOALICIONI NISMA - SHQIPËRIA BËHET

Link: <https://www.shqiperiabehet.al/>

Kryetar: Adriatik Lapaj



Nisma "Thurje" dhe iniciativa "Shqipëria bëhet" u shkrinë së bashku në një lëvizje me emërtimin "Koalicioni Nisma - Shqipëria bëhet", e drejtuar nga juristi Adriatik Lapaj. Ajo është një lëvizje qytetare, e cila aspiroon forcimin e shtetit të së drejtës, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, garës, meritokracisë dhe funksionimin demokratik të Republikës së Shqipërisë. Bazuar në synimet e Lëvizjes prioritare mbetet adresimi i zgjidhjeve ndaj mungesës së demokracisë reale në Shqipëri duke kërkuar ndryshime themelore për hapjen e garës dhe demokratizimin e Shqipërisë. Nisma "Thurje" mori pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 duke siguruar 0.65% të votave ose rreth 10 mijë vota. Lëvizja "Shqipëria bëhet" synon përfaqësim në parlament dhe nuk ka identifikim mbi ideologjitë politike.

5. MUNDËSIA

Link: <https://mundesia.al/>

Kryetar: Agron Shehaj



"MUNDËSIA" është parti e re politike, e identifikuar si pjesë e qendrës së djathtë, e krijuar nga deputeti Agron Shehaj, i cili në dy legjislaturat e fundit ka përfaqësuar PD. Kjo parti lindi si reagim ndaj situatës në PD dhe opozitë, dhe beson se një parti e qendrës së djathtë mund të përmbushë nevojat e sotme, duke u përqendruar në zhvillim ekonomik, lirinë individuale dhe mbrojtjen e vlerave tradicionale. Përmes inovacionit dhe bashkëpunimit ajo beson se mund të ndërtojë një shoqëri të fortë dhe të qëndrueshme, ku secili ka mundësi. Nuk ka konkurruar më parë në proceset zgjedhore, megjithatë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 Agron Shehaj i renditur me numër 5 në qarkun Tiranë rezultoi i dyti më i votuari në këtë qark me mbi 13 mijë vota. Partia "Mundësia" synon përfaqësim në parlament.

6. LËVIZJA BASHKË

Link: <https://levizjabashke.al/zgjedhjet-2025/programi/>

Kryetar: Arlind Qorri



Lëvizja Bashkë u krijua në dhjetor 2002, bazuar në tre kauza kryesore: në kauzën punëtore për ngritjen e sindikatave të pavarura në sektorë të ndryshëm, në kauzën studentore, si dhe në kauzat e ndryshme sociale. Lëvizja Bashkë i përket botëkuptimit të së majtës demokratike dhe synon një shtet social i cili kujdeset për qytetarët përmes institucioneve publike dhe shërbimeve si në arsim dhe shëndetësi, përmes skemave të pensioneve, strehimit social, transportit publik, kontratave kolektive në punë, taksimit progresiv, mbrojtjes së mjedisit etj. Lëvizja Bashkë ka marrë pjesë në zgjedhjet vendore për bashkinë Tiranë 2023, ku kandidati i saj Arlind Qorri fitoi rreth 4.8% të votave, duke u renditur i treti pas kandidatit të PS dhe PD. Kryetar i këtij subjekti është Arlind Qorri, pedagog në Universitetin e Tiranës. Në zgjedhjet vendore 2023 subjekti mori 7,5 mijë vota ose 0,56% të votave. Lëvizja "Shqipëria bëhet" synon përfaqësim në parlament dhe nuk ka identifikim mbi ideologjitë politike.

7. DJATHTAS PËR ZHVILLIM

Link: <https://lzhk.al/> dhe <https://dijathtas1912.com/>

Kryetar: Dashamir Shehi



Ky grupim përbën një bashkim midis Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, krijuar dhe drejtuar nga deputeti Dashamir Shehi në vitet 2000, si dhe fraksioni i PD i shndërruar në parti politike "Djathtas 1912" i drejtuar nga deputeti Enkelejd Alibeaj. Subjekti është i spektrit të djathtë dhe të dy drejtuesit janë zgjedhur deputetë më 2021 në listën shumëemërore të PD. Baza e programit të tij janë çështjet identifikuese të së djathtës në Shqipëri, prona private, ekonomia e tregut, shteti i së drejtës, familja dhe ish - të përndjekurit politikë. Koalicioni "Djathtas për Zhvillim" synon përfaqësim në parlament.

8. PARTIA KOALICIONI EUROATLANTIK (KEA)

Link: <https://rde.al/>

Kryetar: Endri Hasa



Partia Koalicioni Euroatlantik (KEA) është një subjekt i ri politik i krijuar në prag të fushatës elektorale nga ish- kryetari i PD Lulzim Basha dhe mbështetësit e tij. Fillimisht pritej që ndarja e PD të realizohej në dy parti por me ndarjen e një fraksioni drejt Lëvizjes Djathtas për Zhvillim, KEA mbetet një parti simbolike në zgjedhjet e majit 2025. Duke qenë ish-pjesë e PD KEA është forcë e spektrit të qendrës së djathtë, parimet parimore janë të njëjta me PD, ndryshimet gjenden në rrugëzgjidhjet që ofrohen. Partia Koalicioni Euroatlantik synon përfaqësim në parlament.

9. ALEANCA KOMBËTARE SHQIPTARE (AKSH)

Link: <https://aksh.al>

Kryetar: Eleni Kocaqi



Aleanca Kombëtare Shqiptare (AKSH) është një nismë e re politike, e cila konkurren për herë të parë në zgjedhje. Ajo deklarohet se mbrohet interesat kombëtare brenda dhe jashtë vendit me qëllim kryesor krijimin e një kombi të fortë shqiptar, nëpërmjet rritjes së mirëqenies ekonomike dhe sigurisë kombëtare. Drejtuese e partisë është pedagogia Eleni Kocaqi. AKSH synon përfaqësim në parlament.

10. LËVIZJA ATDHEU

Link: <https://levizjaatdheu.al/>

Kryetar: Kreshnik Osmani



Lëvizja "Atdheu" vjen si një parti e vogël me rol simbolik në spektrin politik shqiptar, e identifikuar si një parti konservatore e qendrës. Ajo ka konkurruar pa sukses në disa zgjedhje, në zgjedhjet e vitit 2025 synon të ketë përfaqësim.

11. PARTIA ALEANCA DEMOKRACIA E RE (ADR)

Link: <https://adr.al/>

Kryetar: Edmond Stojku



Partia Aleanca Demokracia e Re (ADR) vjen si një parti e vogël me rol simbolik në spektrin politik shqiptar. Ajo ka konkurruar pa sukses në disa zgjedhje, në zgjedhjet e vitit 2025 synon të ketë përfaqësim.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë
Krasniqi, Afrim
Broshurë informative mbi zgjedhjet parlamentare 2025 në
Shqipëri / Afrim Krasniqi. - Tiranë : Instituti i Studimeve
Politike, 2025.
... f. ; ... cm.
ISBN 9789928484635
1.Zgjedhje 2.Ligji zgjedhor 3.Shqipëri
342.8(496.5)

